



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 537, datë 25.09.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN
NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS
CIVILE TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 242, DATË 24.05.2023 DHE
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR POZICIONIN E LIRË TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 235, DATË 24.05.2024 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Klodian Kurushi, si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 242 datë 24.05.2023 dhe në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 235 datë 24.05.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR